



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1100/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.Z. B.,I, me nr. Fiskal 601702948, me seli ne Prishtine rr “ Vëllezërit Gervalla” blloku 8 hyrja 2, kundër debitorit “FSF” shpk, me nr. Biznesi 70964562, me seli ne Prishtinë rr.”Pashko Vasa” nr.2-1, përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokateve “Sejdiu&Qerkini”, me seli ne Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1918/22 datë 29.06.2023, me datën 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit B.Z. B.,I, me nr. Fiskal 601702948, me seli ne Prishtine rr. “Vëllezërit Gervalla” blloku 8 hyrja 2, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 1918/22 i datës 29.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkalles e Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 1918/22 dt.29.06.2023, ka Aprovuar si te bazuar prapësimin e debitorit “FSF” shpk, me nr. Biznesi 70964562, me seli ne Prishtinë rr.”Pashko Vasa” nr.2-1 dhe urdhrin përmbarimor P.nr.32/21 dt.03.11.2021 te Përmbaruesit Privat Isak Islami për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë e ka Anuluar, ndërsa e ka detyruar kreditorin që në emër te shpenzimeve për prapësim t’ia paguaj debitorit shumën prej 208.00 euro, ne afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes esenciale te dispozitave të procedurës, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ta detyroj debitorin të paguaj shumën si ne propozimin për përmbarim si dhe i njëjti ti bartë shpenzimet për përpilimin e ankesës.

Përgjigje ne ankesën e kreditorit ka ushtruar debitori, me propozimin qe gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e kreditorit si te pabazuar dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori B.Z. B.,I, me nr. Fiskal 601702948, me seli ne Prishtine rr “ Vëllezërit Gervalla” blloku 8 hyrja 2, me datën 03.11.2021, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit “FSF” shpk, me nr. Biznesi 70964562, me seli ne Prishtinë rr.”Pashko Vasa” nr.2-1, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.001/2020 dt.01.01.2020, 002/2020 dt.01.02.2020, 003/2020 dt.01.03.2020, 004/2020 dt.01.04.2020, 005/2020 dt.01.05.2020, 006/2020 dt.01.06.2020, 007/2020 dt.01.07.2020, 008/2020 dt.01.08.2020, 009/2020 dt.01.09.2020, 010/2020 dt.01.10.2020, 011/2020 dt.01.11.2020, 012/2020 dt.01.12.2020, 001/2021 dt.01.01.2021, 002/2021 dt.01.02.2021, 003/2021 dt.01.03.2021.

Përmbareuesi Privat Isak Islami, nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr.32/21 dt.03.11.2021, ka lejuar përmbaremoren, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura ti paguaj shumen prej 45,194.90 , duke filluar nga data prej 01.01.2020 si edhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin përmbaremore debitori ka paraqitur prapësim me datën 08.12.2021, me pretendimin se dokumenti ne bazë te cilit është lejuar përmbaremore nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare te përmbareueshmërisë, faturat dhe dokumentet e paraqitura propozimit për përmbaremore janë fatura te njëanshme, te njëjtat janë te papranuara dhe panëshkruara nga debitori. Debitori i referohet nenit 38 te LPP-së, duke arsyetuar se duhet te plotësohen kushtet ligjore ne mënyrë kumulative qe një dokument te jetë ne përputhje me dispozitat ligjore, debitori asnjëherë nuk ka pranuar faturat e kreditorit ashtu qe nuk ka pasur mundësinë që të njëjtat ti kontestoj as për nga koha e arritjes për as nga vëllimi i tyre. Debitori i referohet edhe nenit 40 par.2 te LPP si dhe aktvendimit te Gjykatës e Apelit Ac.nr.540/17 dt.15.02.2018, andaj propozon qe gjykata ta aprovoj këtë ankesë, urdhrin përmbaremore ta shfuqizoj dhe ta detyroj kreditorin te paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 10.12.2021, me arsyetimin se e kundërshton prapësimin e debitorit dhe thekson se borxhi nuk është paguar sa i përket faturave, kjo vërtetohet dhe përmes kartelës te procesit te barazimit dt.31.03.2021, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës se Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1918/22 dt.29.06.2023, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbaremore duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe urdhri përmbaremore

duhet te anulohet e kjo mbështetur ne nenin 29 par.3 te LPP sepse faturat sipas se cilave caktohet përbarimi nuk i plotësojnë kushtet ligjore për te qenë dokumente te besueshme, nuk mund te vërtetohet se këto fatura janë pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori, te njëjtave iu mungon nënshkrimi apo vula e debitorit. Sa i përket kartelës se barazimit kontabël dt.31.03.2021 te cilës i referohet kreditori ne përgjigje ne prapësim gjykata gjenë se kjo kartelë e barazimit kontabël nuk paraqet dokument te besueshëm sepse nuk është e paraparë me nenin 29 te LPP si dokument i besueshëm, e njëjta po ashtu është e përpiluar ne mënyrë te njëanshme ndërsa sa i përket shpenzimeve te procedurës kjo gjykatë ka vendosi në kuptim të nenit 463 te LPK dhe nenin 17 te LPP, andaj edhe ka vendos si ne dispozitiv te vendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përbarimi është lejuar në bazë të faturave te lëshuara nga kreditori, por te cilat fatura nuk janë ne pajtim me dispozitat ligjore nga neni 29 par.3 te LPP-së.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon ne tërësi edhe kjo gjykatë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Edhe kjo gjykatë vlerëson se faturat me numër nr.001/2020 dt.01.01.2020, 002/2020 dt.01.02.2020, 003/2020 dt.01.03.2020, 004/2020 dt.01.04.2020, 005/2020 dt.01.05.2020, 006/2020 dt.01.06.2020, 007/2020 dt.01.07.2020, 008/2020 dt.01.08.2020, 009/2020 dt.01.09.2020, 010/2020 dt.01.10.2020, 011/2020 dt.01.11.2020, 012/2020 dt.01.12.2020, 001/2021 dt.01.01.2021, 002/2021 dt.01.02.2021, 003/2021 dt.01.03.2021, mbi bazën e te cilave është lejuar përbarimi, nuk janë ne pajtim me dispozitat ligjore dhe atë nenin 29 par.3 te LPP i cili parasheh qe “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*” e po ashtu edhe Udhëzimit administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, e që në rastin konkret këto fatura nuk janë te nënshkruara apo te vulosura nga debitori, element ky bazë qe shpreh vërtetësinë e pranimit te një dokumenti ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se debitori i ka pranuar këto fatura ne mënyrë të rregullt, ashtu që të njëjtat konsiderohet se janë lëshuar njëanshëm.

Sa i përket Kartelës së barazimit kontabël dt.31.03.2021 të cilës i referohet kreditori në përgjigje në prapësim gjykata gjënë se kjo kartelë e barazimit kontabël, edhe kjo gjykate vlerëson po ashtu se nuk mund të konsiderohet dokument i besueshëm sepse sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar qartë dokumentet të cilat konsiderohen si dokumente të besueshme por jo edhe Kartela e barazimit. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur edhe konform nenit 463 të LPK përkitazi shpenzimeve të procedurës.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi pretendimet e kreditorit por vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara dhe të paargumentuara me prova juridikisht të vlefshme, prandaj i refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar të shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarimor që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1100//23, me datë 04.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha